



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 198, Datë 24.11.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË “HEC LLËNGË”
SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC-ET “LLËNGA 1” DHE “LLËNGA 2&3” ME FUQI TOTALE 3.7 MW**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 gërma ‘a’ të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për Organizimin, Funkionimin dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “HEC LLËNGË” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Llënga 1” dhe “Llënga 2 & 3” me fuqi totale të instaluar 3.7 MW, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HEC LLËNGË” sh.p.k me shkresën nr. 692 Prot i ERE, datë 30.10.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Llënga 1” dhe “Llënga 2 & 3” me fuqi të instaluar 3.7 MW.
- Aplikimi i shoqërisë “HEC Llëngë” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko - ekonomik (neni 9, pikat, 4.1.2, 4.1.3; dhe 4.1.4 gërmat “b”, “c”, “d”, “e”; 4.1.5 gërma “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar, që ka të bëjë me nenin 9, pika 3, gërma “c”, neni 9, pikat 4.1.1, neni 9 pika 4.1.4, gërma “a” neni 9, pika 4.1.5 gërmat “a” dhe “b”, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike“, neni 11, pika 1, t’i paraqesë ato në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC LLËNGË” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC – et Llënga 1” dhe “Llënga 2 dhe 3” me fuqi totale të instaluar 3.7 MW.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi, mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI